



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 57, datë 17.07.2026

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT NË FORMËN E TRANSFERTËS TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE NË KODIN AD, PËR OBJEKTIN “MURE MBAJTËS NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 1 DHE NR. 2”

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile nr.429/6 prot, datë 15.04.2026 “Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, protokolluar me tonën nr.5138 prot, datë 20.04.2026, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” i ndryshuar, Marrëveshjen Kuadër nr.1298/19 prot, datë 27.11.2025, me objekt “Hartimi i masterplaneve dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit për objekte civile, industriale, sportive, rezidenciale, vepra të ujitjes-kullimit dhe infrastruktura rrugore në territorin e Bashkisë Durrës”, kontrata e shërbimit nr.210/32 prot, datë 03.06.2026 me objekt “Studim projektim ndërhyrje emergjente rehabilituese-përforcuese për rrëshqitjet e terrenit në njësitë administrative nr.1, nr.2, nr.4, nr.6, Sukth, Manëz, Katund i Ri dhe Rrashbull”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik dhe Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e përdorimit të fondit në formën e transfertës së kushtëzuar nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile, në kodin AD, në vlerën 15,424,018 lekë, për realizimin e projekt-preventivave "Mure Mbjtëse", sipas tabelës së mëposhtme.

Titulli i projektit	Vlera e projektit në lekë
Mure mbajtës në njësinë administrative nr.1 dhe nr.2	14,976,229
Mbikqyrje objekti: Mure mbajtës në njësinë administrative nr.1 dhe nr.2	389,382
Koalodim objekti: Mure mbajtës në njësinë administrative nr.1 dhe nr.2	58,407
Total	15,424,018

2. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile në Bashkinë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.



U shpall sot me datë 20.07.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 566/ prot.
15

Durrës, më 27.07.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.57 datë 17.07.2026 “Për miratimin e përdorimit të fondit në formën e transfertës të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile në kodin AD, për objektin “ Mure mbajtës në njësinë Administrative nr.1 dhe nr.2”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
ADRIAN GURRA**

